

VENDIM
Nr. 869, datë 27.12.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.213, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇAKTIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE SI NJËSI ZBATUESE, DHE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RESTAURIMIT/RINDËRTIMIT TË PASURIVE KULTURORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 213, datë 11.03.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, vlera “236 627 069 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë” zëvendësohet me “223 105 319 (dyqind e njëzet e tre milionë e njëqind e pesë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë”.
 - b) Në shkronjën “b”, të pikës 1, fjalët “... 39 126 485 (tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohen me “... 25 604 735 (njëzet e pesë milionë e gjashtëqind e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH ...”.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama